



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Kërkesa nr. 26

Data 10.5.2023
Nr. Prot 4911

KËRKUES: KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

OBJEKTË: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Z. Ivi Kaso ka depozituar denoncimin regjistruar me numër regjistri 379 ID, për të cilin pretendohet se ka patur përdorim të burimeve publike për qëllime zgjedhore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në vijim të procedurës administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 379 ID përbën shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe duhet t'i tërhiqet vëmendja personave përgjegjës në mënyrë që të tregohet kujdes në postimin dhe ripostimin e veprimtarive të ndryshme.

Referuar nenit nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, *dënohet me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.*

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator", i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- **z. Arben Qafa, drejtor i Qendrës Kulturore "Margarita Tutulani" Berat, në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë.**

Nga të dhënat, rezulton se z. Arben Qafa, nuk është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 471, datë 09.05.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
- Denoncimi administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 379 ID

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:
E. Mema
I. Horanlliu
M. Koja
A. Lamçe
Y. Merkaç

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Partia Demokratike

SEKRETARI PËR ÇËSHTJET ZGJEDHORE

Nr. 173 Prot.

Datë ..03.05..2023

Objekti: Ankesë për kryerjen e veprimtarive publike të ndaluara përpara zgjedhjeve

Drejtuar: z. Ilirjan Celibashi
Kryetar
Komisioni Qëndror Zgjedhor

Baza Ligjore: Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
Vendimi i Komisionit Rregullator (KOZ) nr.9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, të administratës shtetërore përpara zgjedhjeve”;
Urdhër i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KOZ) nr.46, datë 22.01.2021 “Për përditësimin e listës së institucioneve qendrore dhe vendore të pavarura e të varësisë, që janë të detyruara të raportojnë në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve

I nderuar Zoti Komisioner,

Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”, në faqen e saj në rrjetin social FB shpërndan dhe kryen aktivitet propagandistik elektoral në favor të kryetarit aktual të bashkisë Berat z. Ervin Demo, sipas provave këto **në kundërshtim me dispozitat ligjore si më lart.**

Në këto kushte, Partia Demokratike e Shqipërisë **kërkon** marrjen e masave të menjëherëshme përfshirë saksionet të parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura bashkëlidhur.

SEKRETARI PËR ÇËSHTJET ZGJEDHORE

z.IVI KASO



KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE
ADRESIMI I DOKUMENTACIONIT HYRËS NË KQZ

Drejtorise që i shkon dokumentacioni:

Veprimet e rekomanduara

Kabineti

Përgjigje

SP

Seancë publike

SAB

Ndjekje/ Raportim

DPAZ

Shqyrtim

DAZ

Dijeni

DLD

Vlerësim

DVJ

Rekomandime të tjera

DSZMFM

DPRRESHM

DL

DKK

DMB

DBNJSHM

Afati

ditë


KOMISIONERI
Ilirjan Celibashi

- Mon 19:41
- Sun 19:02
- Sat 18:06
- 2023-04-26 22:09
- 2023-04-26 11:59
- 2023-04-25 00:08
- 2023-04-25 00:01
- 2023-04-24 21:07
- 2023-04-23 12:51
- 2023-04-23 11:46
- 2023-04-23 11:45
- 2023-04-22 16:41
- 2023-04-22 16:40
- 2023-04-22 16:38

Byzja Eskizh

- Denoncim
- Y/3
- Dergim informacioni
- Skoloi Jeshitit
- Pershendellet
- shiban heshimi
- Albani hashihini
- Akti Bera
- Denoncime duures
- Byzja Eskizh
- Denoncim Berat
- Dergis Eskizh
- Denoncim Berat
- Ledia sh shu
- Paralufi Lushnje
- Byzja Eskizh
- Denoncime
- Email Subject
- Re: Denoncim per gjeendjen e plazhit te Ksarollit ne prag sezoni turistik...
- Email Subject
- Denoncim per gjeendjen e plazhit te Ksarollit ne prag sezoni turistik.
- Asi Bera
- raportime duures
- Era B Si
- Lutem t'i bene publike se faktet jane te verteta dhe iua dergoni edhe g...
- arrancipollumbi
- FW: Materiale shtese mbi Denoncimin e abuzimit elektorral. Bashkua...
- emolpçilumbi
- FW: Materiale shtese mbi Denoncimin e abuzimit elektorral. Bashkua...
- emolpçilumbi

QK Margarita Tutulani



2.2K followers • 1 following

Message Follow

